




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIK E KOSOVAREPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 2-D/DPK	B. Prot. 01-2083/2012
Nr. i faq.	Data
Broj stranica 03	Datum 13.06.2012
Nr. pages	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.05.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti me nr. AKK– 03-4394/11, për, **z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës**, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli, AKK– 03-4394/11, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë **z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës**. Pas zhvillimit të procedurës, dhe analizimit të gjendjes, është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit, në këtë periudhë, pasi që **z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës**, me datën 19.12.2011, i është drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit me kërkesën për interpretim dhe vlerësimin e gjendjes së mundshme të Konfliktit të interesit në procesin e nënshkrimit të kontratës me kompani N.Sh.CMB dhe ko producentit P.K.Isstra, në të cilën ko producent dhe bashkëpronarë në këtë kompani është **z.Shkumbin Istrefi** me të cilin thotë se ka lidhje familjare, (është i martuar me motrën e tij).

Kjo kompani dhe Projekti filmik me datën 19.11.2011, është përzgjedhur nga juria vlerësuese e QKK-së, si njeri ndër projektet fituese, ndërsa në të njëjtën datë Këshilli drejtues i QKK-së, ka sjell vendim për subvencionimin e projekteve filmike për vitin 2011, bazuar në ligjin për Kinematografin, e ku njëra nga fitueset e konkursit vjetor për projektet filmikë, të hapur nga QKK-ja në muajin Maj –Qershor 2011, është Projekti filmik “Tri Dritare dhe një Varje”.me skenar të Zymer Kelmendit dhe regji të Isa Qosjes i Kompanis N.SH.CMB.

Zyrtari i Lartë z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës, ne kërkesën e tij e përshkruan procesin e përzgjedhjes së tij si drejtor i QKK-së, si dhe procesin e projekteve filmike që do të subvencionohen nga QKK-ja, e që janë përzgjedhur nga juria vlerësuese të emëruara nga këshilli Drejtues i QKK- së.

Pas analizimit të gjendjes zyrtare të Agjencisë kanë kontaktuar me z.Fatos Berisha dhe janë takuar për të biseduar lidhur me situatën e mundshme të konfliktit të interesit. Në takim e mbajtur është pyetur për procesin e emërimit të tij dhe përzgjedhjen e projekteve filmike që do të subvencionohen nga QKK-ja, si dhe është kërkuar nga ai që të paraqet dokumentacionin lidhur me këtë proces.

Zyrtaret e agjencisë e kanë njoftuar z.Fatos Berisha, se pa së analizimit dhe vlerësimit të kësaj gjendje dhe dokumentacionit të ofruar, do ta njoftojnë me shkrim për hapat që duhet ndërmarre ai për situatën që gjendet.

Me datën 22.12.2011, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar me shkrim z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës se nënshkrimi i kontratës nga ana e tij me kompaninë N.SH.CMB, ku, ko producent është z.Shkumbin Istrefi, me të cilin z.Berisha ka lidhje familjare e që është njëra ndër kompanitë e përzgjedhura nga juria vlerësuese për projektin filmik “Tri Dritare dhe një varje” më skenar të Zymber Avdiut dhe regji të Isa Qosjes, që do të subvencionohen nga QKK-ja, nuk duhet të nënshkruhet nga ana e tij por të delegohet nga organi apo institucioni me i lartë mbikëqyrës, për arsye se në të kundërtën në bazë të informacioneve dhe provave që disponon Agjencia kundër Korrupsionit gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L.051, do të shfaqej gjendja e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Me datën 02.03.2012, Ministria e Kulturës ka sjellë Kontratën dhe korrespondencën që z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës ka pasur me Sekretarin e Përhershëm të Ministrisë së Kulturës, lidhur me delegimin e kompetencës për nënshkrimin e vendimit apo kontratës lidhur me kompaninë e përzgjedhur nga juria vlerësuese për projektin filmik “Tri Dritare dhe një varje” më skenar të Zymber Avdiut dhe regji të Isa Qosjes, pas shkresës njoftuese nga Agjencia kundër Korrupsionit, për veprimet që duhet marrë, për të mos u gjendur në gjendje të konfliktit të Interesit.

Pas analizimit të dokumentacionit Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës, nuk ka qenë nënshkrues i kontratës për subvencionimin e projektit filmik të përzgjedhur nga juria vlerësuese e QKK-së, andaj konsiderojmë se z.Fatos Berisha, Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës, me delegimin e kompetencës për nënshkrim të Kontratës, tek organi mbikëqyrës me i lartë i tij, ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit, pasi që nuk ka qenë personi që ka nënshkruar dhe vendosur për zgjedhjen e këtij projekti dhe nuk ka nënshkruar kontratën në të cilën munde të shkaktonte gjendjen se konfliktit të interesit.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

